



Pranimi / Primesha / Received / Delivered	08.03.2023	3	viti / god / year
Organ / Mjesta / Organ / Jedinstvo / Org. Unit	Nr. Prot. / Broj Prot. / Prot. No.	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKMSTHCK	2510/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.759/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga; Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Arben Mehmeti, anëtar, si dhe Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin AA.nr.712/2022 të datës 02.02.2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.653/2018 të datës 15.10.2018 të ankuesit _____, me adresë rruga "Ndue Perleshi", Nr. 3, Mati 1, në Prishtinë, kundër organit të punësimit/Ministria e Drejtësisë, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në pajtim me Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 08.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.653/2018 të datës 15.10.2018 të ankuesit _____
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.Prot: 3570KA/05/2018 i datës 05.10.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Drejtësisë.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën Avokat Shtetëror në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, më datë 03.07.2018 ka parashtruar kërkesë për pushim vjetor për periudhën 09.07.2018 deri më datë 22.08.2018 e cila i është aprovuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. Për shkak përfaqësimit që bënë Avokatura Shtetërore, ankuesit më datë 18.07.2018, 20.07.2018, 23.07.2018, 24.07.2018, 25.07.2018, 26.07.2018, 27.07.2018, 30.07.2018 i janë caktuar seanca gjyqësore në Gjykatat Themelore të Komunave të ndryshme, po ashtu seanca ankuesit i janë caktuar edhe nga data 01.08.2018 deri më datë 17.08.2018.

Më datë 24.09.2018 ankuesi ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave të Ministrisë së Drejtësisë, për kompensimin e pushimit vjetor nga data 18.07.2018 deri më datë 22.08.2018, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Drejtësisë përmes Vendimit me Nr.Prot: 3570 KA/05/2018 të datës 05.10.2018 është shpall jokompetent për të vendosur për këtë ankesë. Ankuesi kundër këtij vendimi më datë 15.10.2018 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.11.2018 ka nxjerr Vendim me numër A.nr. 653/2018 me të cilin vendim ka hedhur poshtë ankesën e ankuesit si të palejuar. Ankuesi kundër Vendimit A.nr. 653/2018 të datës 29.11.2018 të Këshillit, ka hapur konflikt administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit A.nr. 2912/2018 të datë 05.08.2022, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke e anuluar Vendimin A.nr.653/2018 të datës 29.11.2018, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër këtij aktgjykimi parashtron ankesë tek Gjykata e Apelit në Prishtinë, ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës më datë 02.02.2022 ka nxjerr Aktgjykim AA.nr. 712/2022, me të cilin ka refuzuar ankesën e Këshillit si të pabazuar duke vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.653/2018, e datës 15.10.2018, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimi A. A. nr. 712/2012, i datës 02.02.2023, i Gjykatës së Apelit; Aktgjykimi A. Nr. 2912/18, i datës 05.08.2022, i Gjykatës Themelore në Prishtinë /Departamenti për Çështje Administrative; Vendimi me numër protokolli 3570 KA/05/2018, i datës 05.10.2018, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Autorizimi i datës 26.07.2018; Kërkese për shërbimin e vozitjes e datës 18.07.2018; ; Kërkese për shërbimin e vozitjes e datës 20.07.2018;Kërkese për shërbimin e vozitjes e datës 23.07.2018; ; Kërkese për shërbimin e vozitjes e datës 24.07.2018; Kërkese për shërbimin e vozitjes e datës 25.07.2018; ; Kërkese për shërbimin e vozitjes e datës 26.07.2018; Kërkese për shërbimin e vozitjes e datës 27.07.2018; Kërkese për shërbimin e vozitjes e datës 30.07.2018;Kërkese për shërbimin e vozitjes e datës 01.08.2018; Kërkese për shërbimin e vozitjes e datës 02.08.2018; e-maili i datës 01.08.2018 Kërkese për shërbimin e vozitjes e datës 06.08.2018; Kërkese për shërbimin e vozitjes e datës 08.08.2018; ; Kërkese për shërbimin e vozitjes e datës 09.08.2018; Kërkese për shërbimin e vozitjes e datës 10.08.2018; Kërkese për shërbimin e vozitjes e datës 13.08.2018; Kërkese për shërbimin e vozitjes e datës 14.08.2018; ; Kërkese për shërbimin e vozitjes e datës 15.08.2018; Ankesë me numër 10-2570/3 e datës 24.09.2018, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; E-maili i datës 27.08.2018; E-maili i datës 30.07.2018; E-maili i datës 01.08.2018; E-maili i datës 03.08.2018; E-maili i datës 06.08.2018; E-maili i datës 07.08.2018; E-maili i datës 08.08.2018; E-maili i datës 09.08.2018; E-maili i datës 07.09.2018; E-maili i datës 10.08.2018; E-maili i datës 14.08.2018; E-maili i datës 15.08.2018; Kërkesa për pushim e datës 04.07.2018; Vendimi A. Nr. 653/20218, i datës 29.11.2018, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në ankesë e datës 19.10.2018, me numër protokolli 6193/2018.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar *sepse*:

Kolegji i Këshillit, marrë për bazë Aktgjykimin AA.nr. 712/2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe Aktgjykimin A.nr.2912/2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Departamenti për Çështje Administrative, po ashtu edhe referuar dispozitave të nenit 16 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit Nr. 04/L-157 për Avokaturën Shtetërore, i cili përcakton se: *"Avokati i Përgjithshëm Shtetëror dhe avokatët shtetëror emërohen me konkurs publik sipas procedurës së paraparë me dispozitat për emërimin për pozitat e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. 4. Avokatët shtetëror në Avokaturën Shtetërore emërohen me konkurs të hapur publik nga Ministria e Drejtësisë në pajtim me dispozitat për Shërbimin Civil për emërimin për pozitat e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Për emërimin e avokatëve shtetëror përshtatshmërisht zbatohen dispozitat për emërimin e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror"*, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Drejtësisë nuk ka qenë kompetent për të vendosur për ankesën e avokatit shtetëror për shkak që avokatet shtetëror janë emëruar sipas legjislacionit për pozitat e larta drejtuese në Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa kompetent për shqyrtimin e ankesave ka qenë Komisionin i Ankesave për Pozitat e Larta Drejtuese, mbi këtë bazë Vendimi me Nr.Prot: 3570KA/05/2018 i datës 05.10.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Drejtësisë në këtë kuptim është i ligjshëm, mirëpo Kolegji i Këshillit, duke ju referuar Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative respektivisht nenit 75 paragrafi 1, është përcaktuar se: *"Kur një organ publik merr një kërkesë me shkrim që është jashtë kompetencave të veta, pa vonesë do t'ia kalojë kërkesën organit kompetent dhe do të njoftojë dërguesin për këtë"*, si rezultat i kësaj Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Drejtësisë në pajtim me këtë dispozitë ka qenë i obliguar që ankesën e ankuesit ta delegoj tek organi komentet respektivisht tek Komisionit i Ankesave për Pozitat e Larta Drejtuese, ndërsa këtë nuk e ka bërë.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të kësaj çështje juridike, konstaton se në kohën kur lënda e ankuesit është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka ndryshuar baza ligjore lidhur me marrëdhënien e punës së nëpunësve civil respektivisht nga muaji korrik i vitit 2020 është duke u zbatuar Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, i cili nuk ka paraparë organ administrativ respektivisht nuk ka paraparë Komision për shqyrtimin e ankesave të nëpunësve civil të të gjitha kategorive, rrjedhimisht edhe në këtë kohë lënda nuk mund të delegohet tek ish Komisioni për Ankesa për Pozitat e Nivelit të Lartë Drejtues.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, për kompensimin e pushimit vjetor të pashfrytëzuar për vitin 2018 konkretisht për periudhën 18.07.2018 deri më datë 22.08.2018, Kolegji i Këshillit, ju referuar legjislacionit përkatës të aplikuar në këtë periudhë, respektivisht neni 39 paragrafi 7 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përcakton se: *"Pushimi vjetor nuk mund të shndërrohet në formë tjetër kompensimi monetar ose jo monetar"*, si dhe nenit 5 paragrafi 6 të Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, i cili përcakton se: *"Pushimi vjetor nuk mund të shndërrohet në formë tjetër kompensimi monetar ose jomonetar"*, përjashtimisht në rastet e

ndërprerjes së marrëdhënies së punës siç parashihet me paragrafin 8 të nenit 5 të kësaj rregulloreje, i cili përcakton se: *“Në rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në Shërbimi Civil, nëpunësi civil kompensohet me pagesë të kalkuluar për ditët e pushimit të pushimit vjetor. Në rastin e kundërt, nëse ditët e pushimit vjetor janë shfrytëzuar para kohës së fitimit të drejtës për pushim, atëherë nga paga e fundit bëhen ndalesat e kalkuluara për ditët e pafituara”.*

Duke marr parasysh të lartcekurat, si dhe duke marr për bazë thëniet e ankuesit në seancë gjyqësor e që janë përshkuar në Aktgjykimin A.nr.2912/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, i cili ka deklaruar se *“...kam pranuar vendimin për pushim vjetor që përfshihet periudha nga data 09.07.2018 deri më datën 22.08.2018, gjithsejtë 33 ditë, meqenëse e paditura Ministria e Drejtësisë më datë 18.07.2018 më ka thirr në telefon me pëlqimin tim kam pranuar të ndërpresë pushimin dhe të shkoj në përfaqësim...”,* rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, marr për bazë dispozitat e lartcekura, konstaton se kompensimi i pushimit vjetor në rastin konkret të ankuesit nuk mund të realizohet, kështu që pretendimet e tij janë të pabazuara.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitave të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.759/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Avokatit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.